**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit**

Datë 10.02.2026

# RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NGA GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR VITIN 2025.**

**Baza ligjore:**

Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.1, datë 11.07.2025, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", shkresë e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 Prot., datë 19.12.2025, e cila përcjell vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, që ka përfituar bashkia Durrës.

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5,024,923.98 (pesëmilion e njëzet e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë të përfituar nga Granti i Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025 për: "Blerjen e mjeteve didaktike për pajisjen e institucioneve të arsimit parashkollor (kopshteve) në territorin e Bashkisë Durrës.

2. Ky fond do të financohet në vlerën 2,247,191.01 (dymilion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e një qind e nëntëdhjetë e një pikë zero një) lekë nga buxheti i shtetit dhe në vlerën 2,777,732.97 (dymilion e shtatë qind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë është financim i huaj.

3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteve Fetare , Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij projektvendimi

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fonde nga buxheti i shtetit dhe financim i huaj.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare.

**Impakti social/grupet që preken:**

Fëmijët e kopshteve të bashkisë Durrës.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, u mblodhë më datë 10.02.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 11 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

U mblodh komisioni për pikën 11 të rendit të ditës. Kryetari i komisionit shpjegoi me qartësi pikën bashkë me përfaqësuesin e bashkisë. Nga anëtarët e komisionit nuk pati pyetje dhe ramë dakord për kalimin e pikës në mbledhjen e këshillit.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ____________________________

**Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit**

Kryetar Kastriot Xhongoli

| | |
|---|---|
| Zv/Kryetar | Blerina Reçi |
| Sekretar | Ilir Paja |
| Anëtar | Nurije Gjoni |
| Anëtar | Ermal Braholli |